



## **RREGULLORE**

### **MBI FUSHATEN ZGJEDHORE TE KSSH PER VITIN 2019**

#### **Pranimi anëtar**

Në KSSH, nëpërmjet organizatave sindikale, Organizatave Qendrore Sindikale të profesioneve, Federatave, mund të anëtarësohen vullnetarisht të gjithë të punësuarit të sektorit publik ose privat si ata me punë të përkohshme, të papunët, nëpërmjet deklaratës me shkrim në organizatën sindikale përkatëse në ndërmarrje apo institucion dhe pavarësisht nga bindjet politike apo fetare.

Grupe punonjësish apo individë që kërkojnë të anëtarësohen në KSSH nëpërmjet organizatave sindikale, Organizatave Qendrore Sindikale të profesioneve apo federatave (anetare të KSSH), duhet të pranojnë të drejtat që rrjedhin nga Statuti i KSSH, Statuti Federatës përkatëse (anetare të KSSH) dhe pajisjen me Kartën e Anëtarësisë e cila mban shenjen dalluese të KSSH dhe të dhëna specifike ID, Federatën, organizatën ku anëtarësohet dhe rajonin nga vjen i anetaresuari.

Pranimi kolektiv i organizatës sindikale në seksionin sindikal të profesionit miratohet nga Këshilli Drejtues i Federatës përkatëse në përputhje me Statutin e Federatës dhe KSSH-së.

**Anëtari i sindikatës e shpreh vullnetin drejtpërsëdrejti, individualisht, dhe sindikata garanton shanse të barabarta në përfaqësim midis femrave dhe meshkujve.**

Sindikata garanton dhe mbron të gjithë anëtarët e saj, lirinë e shprehjes së mendimeve, pikëpamjeve dhe platformave që synojnë zbatimin dhe përmirësimin e Porgamit dhe të Statutit Konfederativ e Federativ.

Liria e zgjedhjes dhe votimi i fshehtë janë individuale dhe të garantuara.

Drejtimi i Sindikatës, në çdo pjesë të strukturës së saj, është kolegjiale duke zbatuar hierarkinë statutore dhe parimin e solidaritetit.

Iniciativat personale të anëtarit të sindikatës, apo të drejtuesve sindikalë në të gjitha nivelet duhet të jenë në përputhje me Statutin e KSSH-së. Iniciativën personale në emër të KSSH-së, e ka Presidenti i KSSH, ose çdo individ tjetër i mandatuar të përfaqësojë KSSH-në.

Të drejtën e përdorimit të simboleve të KSSH-së, e kanë vetëm institucionet përfaqësuese të KSSH-së, sipas strukturës dhe organigramës së funksionimit në nivel qendror e vendor.

#### **Te drejtat**

- Çdo anëtar i Sindikates, ka të drejte të marrë pjesë në veprimtaritë sindikale në përputhje me rregullat dhe vendimet e organizatës përkatëse dhe në përputhje me Statutin e KSSH-së.
- Të zgjidhet lirisht si përfaqësues i Organizatës Sindikale për të gjitha nivelet sipas rregullave përkatëse.
- Anëtarët e sindikatës janë të barabartë, pavarësisht nga funksionet që kanë brenda saj si dhe gjendja ekonomike e pozicioni shoqëror jashtë saj.
- Të shprehin mendime e të diskutojnë lirisht, të bëjnë propozime e të kërkojnë shpjegime.
- Të kërkojnë mbrojtje të të drejtave të përbashkëta social-ekonomike, kulturore, juridike, etj.

- Në jetën e brendshme të sindikatës, të ketë pjesëmarrje aktive për një funksionim demokratik në përputhje me rregullat.
- Të marrë pjesë në trainimin dhe kualifikimin sindikal.
- Të mbështese dhe të inkurajoje në perputhje me rregullat e vendosura, dhënien dhe marrjen e informacionit në të gjitha nivelet sindikale.

### **Detyrat**

- Të respektojë Statutin e KSSH dhe të Federatës përkatëse si dhe rregulloret e vendimet e te gjithë strukturave sindikale vendimmarrëse.
- Të marrë pjesë në mënyre aktive, në veprimtarinë dhe ne aktivitetin e organizatës sindikale dhe te paguajë kuotat e anëtarësisë ne perputhje me Statutin.
- Të mos shpërdorojë besimin e dhënë dhe të mos marrë përsipër kompetenca që nuk i përkasin sipas Rregullores dhe Statutit te Sindikates.
- Të plotësojë detyrat e caktuara nga strukturat përkatëse, përfaqësuesve të zgjedhur në përputhje me funksionet.
- Të veprojë me solidaritet e kolegjalitet në mbrojtje të interesave kolektive.
- Të pranojë mendimin ndryshe dhe të shprehë lirisht mendimet e veta brenda strukturave sindikale.
- Të respektojë vendimet e shumicës, vendimet e organeve më të larta dhe t'i zbatojë ato.
- Te marrë pjesë ne menyre aktive në lëvizjen sindikale për organizimin dhe veprimin sindikal.
- Të zbatojë në mënyrë të detyrueshme (për të gjithë nivelet e stukturave të KSSH-së), sistemin e vendimmarjes të përcaktuar nëpermjet Statutit e Rregullores, të miratuara nga forumet.

### **Mandati politik i drejtuesit te sindikates (President Konfederate, Sekretar i Përgjithshëm Federate, Kordinator Qarku/Rrethi, Kryetar Organizate)**

#### **Është i papajtueshem:**

- Me funksionin e drejtuesit të partive politike, të shoqatave e organizatave të ndryshme fitimprurëse e jofitimprurëse që kryejnë veprimtari publike e private, si dhe të institucioneve fetare.
- Me funksionet e punëdhënësit apo perfaqesuesit ligjor te tij në të gjithë nivelet qe perfshijne fushat e veprimtarise ekonomike dhe sherbimit publik e privat, qe lidhen ligjerisht apo ekonomikisht me kompanitë, administratat, filialet, zyrat e deges dhe institucionet kerkimore, arsimore, shëndetësore, agjencite mbikqyrese, marketingun, etj., te percaktuara si punëdhënës ne Legjislacionin Shqiptar.
- Me funksionet drejtuese qeveritare apo të drejtuesve të pushtetit vendor, si: Kryetar Komune, Bashkie, Qarku, Prefekturë, Distrikti, Drejtor Drejtorie, në te gjitha strukturat e pushtetit vendor e qendror.

#### **Ështe i pajtueshem:**

- Me funksionin e Deputetit, Gjyqtarit, anetarit te Keshillit të Qarkut, Bashkisë, Komunës, e te bordeve te ndryshme drejtuese e menaxhuese.
- Mandati politik në procesin zgjedhor të drejtimit, të përfaqësimit dhe të vendimmarrjes në të gjitha nivelet: Konfederativ, Federativ, Rajonal e Vendor, zbatohet parimi i shmangies së konfliktit të interesave dhe të konfliktit nepotik. Si modalitete për shmangien e konfliktit të interesave e të konfliktit nepotik në drejtim e përfaqësim, merren ato klasike të pergjithshme si dhe ato që percaktohen në mënyrë të veçantë nga Ligji Shqiptar.
- Mandati politik, në procesin zgjedhor është i papajtueshëm (humbet e drejta për ta fituar) kur dita e fitimit të mandatit, korrespondon me afatin ligjor të mbushjes së moshës së daljes në pension. Përgjashtim bën Rrjeti i Pensionisteve.

- Eshte i papajtueshëm perfitimi i dy mandateve politike brenda strukturave të KSSH-së, nga i njëjti person, brenda nje mandatimi zgjedhor. Mandati i funksionit politik President Konfederate, Sekretar i Përgjithshëm Federate, Kordinator Qarku/Rrethi, kufizohet me dy mandate radhazi, mandati i tretë e me tej fitohet vetëm me mbi 2/3 e votave.
- Mandati politik i strukturave vendore (Kordinator Qarku/Rrethi, Kryetar Organizate), eshte i papajtueshem kur: perfituesi i mandatit nuk eshte me vendbanim ligjor te perhershëm apo me pune te perhershme ne territorin, njësine administrative apo ndermarrjen qe e mandaton.
- Mandati politik i Drejtuesit te Rrjetit te te Rinjve është i papajtueshëm dhe humbet e drejta e përfitimit të tij kur mosha e të zgjedhurit kalon 35 vjet.

### **Funksionimi i strukturave sindikale**

- Strukturat sindikale, punojne dhe përgjigjen për zbatimin e Statutit të KSSH-së, të Rregulloreve e te Vendimeve të të gjithë strukturave sindikale qendrore e vendore.
- Organizon e drejton punën në Federata, Organizata sindikale qendrore, rrethe, ndermarrje, institucione; ne menyre te integruar, duke siguruar nje gjithëpërfshirje ne menyre kapilare ne te gjithë territorin e vendit.
- Të zhvillohen në kohë, ne perputhje me Programin dhe Statutin mbledhjet dhe analizat e çdo niveli, të organizatave apo strukturave sindikale, duke garantuar nje veprimtari normale dhe produktive per te realizuar me sukses te gjithë fushaten zgjedhore te KSSH-së.
- Mbledhjet, janë të vlefshme kur: në to marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të strukturës sindikale përkatëse, ku si rregull ato zhvillohen me një rend dite të paracaktuar nga organi i caktuar për këtë detyrë.
- Në mbledhjet e zakonëshme të organeve drejtuese, mungesa duhet të justifikohet ndërsa, mungesat pa arësye i kalojnë për shqyrtim organizatës dhe organit sindikal nga vjen i zgjedhuri.
- Në çdo mbledhje zgjedhore, mbahet proces-verbal ku dokumentohet: pjesëmarrja, diskutimet, propozimet, kryerja e zgjedhjeve dhe nxjerrja e rezultateve te tyre, si dhe vendimet përfundimtare të mbledhjes. Nje kopje e proces-verbalit te mbledhjes e nenshkruar nga mbajtësi i tij, titullari i struktures qe zhvillon zgjedhjet dhe i deleguari i Asamblesë e përgjithëshme e KSSH-se, apo Presidencës Ekzekutive dergohet brenda 5 (pesë) ditëve ne Departamentin e Organizimit dhe Burimeve Njerëzore te KSSH-së.
- Të gjitha strukturat e zgjedhura, japin llogari para organeve që i kanë zgjedhur për të gjithë veprimtarinë që parashikohet në Statutin e Konfederatës e Federatës.
- Zgjedhjet për forumet sindikale në te gjithë strukturat e KSSH-së, që nga niveli i seksionit, bëhen me votim. Votimi bëhet:
  - \* duke ngritur dorën;
  - \* me apel nominal (me kerkesen e 30 % te pjesmarrësve ne votim);
  - \* me vote te fshehte (kur votohet per emra personash dhe ne menyre te nominuar)
- Ne votimin ku ka kandidatura alternative, fitues shpallet kandidati që fiton më shumë se gjysmën e votave të të pranishmëve. Në rast se, asnjëri prej kandidatëve nuk fiton numrin e nevojshëm të votave, atëhere zhvillohet një raund votim i dytë midis dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave në votimin e parë.
- Deklarimi i votes nuk mund te kaloje kohen maksimale prej 3 (tre) minutash.
- Ne votimin me vote te fshehtë, votuesit i sigurohet infrastruktura logjistike e nevojshme dhe, ai eshte i detyruar te futet ne dhomen e fshehtë te votimit.
- Çdo strukture që voton, krijon dhe miraton Komisionin e Votimit sipas rastit, dhe vendimeve te Asamblesë Përgjithëshme apo Presidencës Ekzekutive të KSSH.
- Delegatët për në Kongresin e KSSH-së, zgjidhen nga Kongreset e Federatave, me propozim të Seksioneve Sindikale, në përpjesëtim me numrin e anëtarësisë me kuotizacion dhe shpërndarjes

gjeografike, sipas numrit të përgjithshëm të delegatëve që përcakton Asambleja e Përgjithshme e KSSH-së.

- Presidenti i KSSH-së, Zv/Presidentet e KSSH-se, Sekretarët e Përgjithshëm e Federatave, Sindikatave Qendrore, anetaret e Këshillit aktual Drejtues të KSSH-së, Kordinatorët e Qarqeve/Rretheve, Perfaqësuesja e Rrjetit të Gruas, Perfaqësuesi i Rrjetit të Rinjeve, Përfaqësuesi i rrjetit të pensionistëve, Kryetari i Komisionit të Statutit dhe Gjykimit Disiplinor, janë delegate me të drejte vote në Kongresin e KSSH-se, si funksione, mbi numrin që përfaqësojnë Federatat.

- Numri i delegateve të Kongresit të KSSH-se, si dhe shpërndarja e tyre sipas Federatave, në përputhje me normat Statutore të perfaqësimit, vendoset në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithëshme, në mbledhjen e parë të bhapjes së fushatës zgjedhore në KSSH.

- Kandidatët për mandat politik, në nivel qendror (funksionin e Presidentit të KSSH-së, Sekretareve të Përgjithshëm të Federatave); duhet të jenë anëtarë të organizmave drejtuese të Konfederatës, Federatave ose Kordinator të Qarqeve/rretheve për një periudhë mbi 3 vjet.

- Qenia e tyre delegatë në strukturën që e zgjedh dhe pranimi me vullnet të lire i kandidimit janë të domosdoshme.

- Në mbështetje të Statutit të KSSH-se, dhe të direktivave të ITUC dhe të ETUC, do të ruhet kufiri minimal mbi 30 % i delegateve gra dhe mbi 30% të rinj (deri në 35 vjeç) minimalisht, kjo shifer do të ruhet dhe në zgjedhjen e strukturave drejtuese në të gjitha nivelet.

- Zgjedhja e delegatëve duhet të bëhet duke iu referuar mesatares së të anëtarësuarve nga vitet 2014-2019, me përjashtim të sindikatave të reja të krijuara gjatë kësaj periudhe, për të cilat merret mesatarja e viteve që kanë funksionuar.

### **Fazat e zgjedhjeve (kalendari)**

- Asambleja Kombëtare e KSSH-se, mbështetur në Statutin e KSSH-se, shpall fushatën zgjedhore në të gjithë strukturat e KSSH-se.

- Fushata zgjedhore e KSSH-se, **fillon më datën 1 Korrik 2019 dhe mbaron në datën 09 Nentor 2019.**

- Në periudhën **1 – 30 Korrik 2019**, do të kryhen zgjedhjet në të gjithë Organizatat dhe Seksionet Sindikale të bazes në të gjitha ndermarrjet, institucionet, kompanitë publike e private.

- Në periudhën **1 – 30 Shtator 2019**, do të kryhen zgjedhjet në të gjitha seksionet e profesioneve, keshillat sindikale të rretheve, rajoneve e qarqeve.

- Në periudhën **1 - 30 Tetor 2019** do të zhvillohen Kongreset e të gjithë Federatave apo Sindikatave qendrore të profesionit nëse ka të tilla.

- Në muajin **Nentor 2019** do të behen përgatitjet dhe zhvillimi i Kongresit të KSSH-se (**9 Nentor 2019**).

- E gjithë fushata zgjedhore në të gjithë strukturat e KSSH-se, do të drejtohet nga Presidenti i KSSH, ZV. Presidenti i KSSH dhe do të udhëhiqet nga Presidenca Ekzekutive e KSSH-se, si dhe do të implementohet e administrohet nga Sekretarët e Përgjithshëm të Federatave, Departamenti i Organizimit dhe Burimeve Njerzore në KSSH, dhe Koordinatorët rajonalë të qarqeve.

- Departamenti Organizimit dhe i Burimeve Njerzore të KSSH-se, në koordinim me kordinatorët vendor të Qarqeve/rretheve, do të hartojnë kalendarin zgjedhor të sindikatave vendore në rrethe e qarqe.

- Në periudhën **1 – 30 Maj 2019**, Federatat në koordinim me Departamentin e Organizimit dhe Burimeve Njerzore të KSSH-se, do të miratojnë në Presidencën Ekzekutive të KSSH-se, kalendarin kombëtar të zhvillimit të zgjedhjeve duke rakorduar zgjedhjet vendore dhe zgjedhjet në nivele qendrore (Kongreset e Federatave), duke caktuar personat përgjegjës dhe siguruar mbështetjen financiare dhe logjistike.

- Ne zbatim të Statutit të KSSH-se, dhe të Legjislacionit Shqiptar në përgjithësi, të gjitha procedurat e zhvillimit të mbledhjeve zgjedhore do të jenë transparente dhe demokratike.

- Asambleja e Përgjithëshme e KSSH-së, në mbledhjen e hapjes së fushatës zgjedhore krijon një Komision prej 5 (pesë) anetaresh të Asamblesë së Përgjithëshme të KSSH-së, për të verifikuar përputhshmerinë statutores të kandidaturave në të gjitha nivelet dhe strukturat drejtuese të KSSH-së. Ky Komision bashkepunon me Komisionin e Statutit, Gjykimin disiplinor dhe financës së KSSH-së, për vendimmarrjen e tij.

- Asambleja e Përgjithëshme e KSSH-se, në mbledhjen e saj të fundit (15 ditë përpara datës së Kongresit të KSSH) miraton kandidaturat për të gjitha strukturat drejtuese të KSSH në konformistët të Nenit Nr. 7 të Statutit të KSSH, Rregullores së Asamblesë së Përgjithëshme të KSSH si dhe të kësaj rregulloreje. Propozimet për President të KSSH duhet të vijnë nga Asambleja e Përgjithëshme e KSSH ose minimalisht të propozohen nga 2 Federata përkatëse në Kongreset e tyre. Pasi këto të kalojnë në Komisionin përkatës të verifikimit të kandidaturave për fushatën zgjedhore të KSSH ato miratohen në Mbledhjen e Asamblesë e cila ja propozon Kongresit.

- Asambleja e Përgjithëshme e KSSH-se, në mbledhjen e saj të fundit (15 ditë përpara datës së Kongresit të KSSH) miraton Përfaqësinë e Kongresit të KSSH-së, të përbërë me nga një përfaqësues për çdo Federatë dhe një përfaqësues për çdo Qark, si dhe dy punonjës të Departamentit Organizimit dhe Burimeve Njerëzore të KSSH-se. Përfaqësia zgjedh Kryetarin dhe Sekretarin e saj, të cilët kanë përgjegjësinë për menaxhimin dhe administrimin e punës përgatitore për Kongresin mbi bazën e detyrave që Asamblesë së Përgjithëshme dhe Presidencës Ekzekutive të KSSH-së që i ngarkon Përfaqësisë së Kongresit.

**Kjo Rregullore shtrin efektet e saj tek të gjithë strukturat organizative të KSSH.**

**Hyn në fuqi sot me date 06.06.2019**